

Të nderuar anëtarë të KOKSH,

Në mbështetje të Rezolutës të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH me datë \_\_ Shkurt 2020 dhe me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të KOKSH, u krijua Komiteti Teknik për rishikimin e Statutit të KOKSH, i përbërë nga një përfaqësues i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (Z. Jerome Poivez), një përfaqësues i Komitetit Olimpik Europian (Z. Domenico DeMarinis), një përfaqësues i MASR (Z. Arjan Konomi) dhe dy përfaqësues të zgjedhur nga anëtarët e KOKSH (Z. Vojo Malo dhe Z. Rezart Spahia). Ky Komitet shqyrtoi, analizoi dhe mori në konsideratë propozimet e bëra nga disa anëtarë të Asamblesë së KOKSH, dhe mbas rishikimit në tërësi të Statutit për përputhshmërinë e tij me kërkesat e Legjislacionit Shqiptar, veçanërisht me ndryshimet e bëra në Ligjin për Sportin dhe sigurisht Kartën Olimpikë arriti në përgatitjen e Projekt Statutit bashkëngjitur. Në lidhje me të, ju lutem vini re sa më poshtë.

#### **KRIJIMI I KOMISIONIT TË VERIFIKIMEVE DHE ETIKËS (KVE)**

Një çështje e veçantë dhe shumë e rëndësishme që është shtuar në Projekt Statut është krijimi i Komisionit të Verifikimeve dhe Etikës (KVE) që duhet të zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme. Ky Komision i konceptuar të jetë me anëtarë të pavarur nga KOKSH parashikohet të ketë një rol të rëndësishëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së KOKSH, përfshirë për verifikimin e kandidatave të ndryshme të propozuara për tu zgjedhur si dhe për mbikqyrjen e procesit zgjedhor. Në mënyrë që ky komision të zgjidhet në të njëjtën asamble ku do të bëhet edhe miratimi i ndryshimeve të statutit, dhe më pas të ketë mundësi të luajë rolin e tij për zgjedhjet e parashikuara brenda vitit 2020, jeni të lutur të bëni propozimet tuaja për individë që plotësojnë kushtet e parashikuara në Projekt Statutin bashkëngjitur.

Propozimet tuaja për anëtarët e KVE duhet të dorëzohen pranë Komitetit Ekzekutiv jo më vonë se sa 20 ditë para datës së Asamblesë së Përgjithshme.

#### **DISPOZITA ALTERNATIVE**

Komisioni në përgjithësi punoi me një frymë shumë të mirë bashkëpunimi që shpresojmë është reflektuar dhe në dokumentin bashkëngjitur. Megjithatë, pavarësisht prej dëshirës për të arritur në një draft unanim, anëtarët e komisionit patën mendime të ndryshme vetëm për tre (3) pika/çështje. Për këtë arsye ato i janë lënë Asamblesë për të vendosur. Dispozitat mbi të cilat nuk pati unanimitet janë evidentuar në statut me ngjyrë të verdhë unanimitet dhe janë:

- 1) **Anëtarët me titull individual me të drejtë vote.** Statusi i këtyre anëtarëve individualë është aktiv në Statutin ekzistues të miratuar nga Asambleja që në vitin 2012. Disa anëtarë të Asamblesë kërkuan që këta individë të mos jenë më në përbërjen e KOKSH. Komiteti pati qëndrime të ndryshme si vijon:
  - a. **Argumentat Kryesore Pro Heqjes:**
    - (i) Argumentimi Pro për heqjen e kësaj kategorie anëtarësh i tyre është se një individ nuk mund të barazojë të drejtën e votës me anëtarë të tjerë që janë persona juridik, Federata të cilat ushtrojnë sporte me numër të madh pjesëmarrësish në gara duke dhënë kontribut të rëndësishëm në Lëvizjen Olimpikë.

- (ii) Nga mbi 10 Komitete Olimpikë të vendeve të ndryshme që Komiteti munda të hulumtojë (përfshi Itali, Francë, Kosovë, Austri, Belgjike, Kroaci, Irlandë, Spanjë, Sllovaki) asnjë, përveç Gjermanisë, nuk e kishte këtë kategori anëtarësh.
- (iii) Kontributi i individëve në KOKSH mund të arrihet duke përdorur mekanizmin e anëtarit nderi të KOKSH, i cili i jep një rol nderues për individët me kontribut të spikatur, por pa të drejtë vote.
  - b. Argumentat kryesore pro mbajtjes:
    - (i) Këta janë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e KOKSH dhe nuk mund të hiqen si të tillë nga Komiteti Teknik;
    - (ii) Karta Olimpikë lejon përfshirjen në anëtarësinë të individëve që kanë dhënë kontribut të spikatur/rëndësishëm në Lëvizjen Olimpikë.

2) **Mos përfshirja në politikë e kandidatit për President të KOKSH;**

Përcaktimi i kriterëve, si të anëtarësisë së KOKSH ashtu edhe të të zgjedhurve të tij, është një risi e ndryshimeve të propozuara për tu bërë në statutin ekzistues. Një nga kriteret e propozuara për të qënë kandidat për president është përfshirja në politikë. Anëtarët e Komitetit nuk u dakordësuan për këtë kriter.

- (i) Argument pro, për vendosjen e këtij kriteri për kandidatët për President është fakti i dakordësuar se përpara votimit për President duhet që ndaj kandidatëve të bëhet veting. Një nga kushtet përjashtuese të vetingut duhet të jetë mospërfshirja në politikë e kandidatit për një periudhë 5 vjeçare përpara kandidimit në mënyrë që të minimizohet ndikimi politik (i drejtpërdrejtë apo tërthorë) mbi veprimtarinë e KOKSH.
- (ii) Argumentet kundër ishin që (1) ky propozim nuk ka ardhur nga antaret KOKSH në momentin që i është kërkuar mendim për ndryshimet statutore, (2) nuk ka përcaktim përjashtimor në asnjë nga aktet ligjore dhe nën ligjore për fushën e veprimtarisë së sportit që e mbështet si kriter, (3) nuk cenon Kartën olimpikë (4) anëtarësia e KOKSH duhet të jetë në gjendje të gjykojë vetë nëse një individ i caktuar është vlerë e shtuar apo jo për KOKSH, pavarësisht angazhimit të tij politik.

3) **Nëse Shoqatat Sportive që drejtojnë sport të përfshirë në Lojrat Olimpikë duhet të kenë 2 apo 1 votë në Asamblatë e KOKSH.**

- (i) Argument pro. Në statutin ekzistues nuk bëhet dallim, si për anëtarësimin ashtu dhe për të drejtën e votës midis Federatave që ushtrojnë sport të përfshirë në Lojrat Olimpikë dhe Shoqatave që ushtrojnë sport të përfshirë në Lojrat Olimpikë. Në fund të fundit edhe Federatat nga forma e tyre juridike janë shoqata të regjistruara në të njëjtin regjistër në Gjykatë, aty ku janë të regjistruara edhe Shoqatat. Gjithashtu Komiteti Olimpik Ndërkombëtar dhe Federatat Ndërkombëtare të sporteve të ndryshme nuk bëjnë dallim midis statusit Federatë dhe/apo Shoqatë.
- (ii) Argument kundër. Mendimi i kundërt thekson se Ligji i Sportit bën dallim të qartë se kush ngelet shoqatë dhe kush bëhet federatë. Dhe kjo nën kupton faktin që bashkimi i shoqatave në federatë e cila merr titullin sipas përcaktimeve që jep ligji për sportin. Një tjetër argument kundër është se këto shoqata mund të vendosin të rrinë si të tilla por nuk mund të bëhen pjesë e sistemit sportiv kombëtar. Pra aktiviteti i tyre është vetëm në nivel lokal dhe pse janë anëtarë të federatës ndërkombëtare respektive.

## **AFAT PËR MENDIMET TUAJA**

Komiteti Teknik do e vlerësonte maksimalisht sikur pasi të keni lexuar dhe reflektuar mbi ndryshimet e propozuara të Statutit të na dergoni mendimet tuaja me email në lidhje me ndryshimet e bëra si dhe nëse shihni ndonjë mangësi që duhet adresuar. *Afati për këtë është 5 ditë nga dita e nesërme.*

## **KONSULTE PARAPRAKE ME KOMITETIN TEKNIK**

Në mënyrë që të kontribuojmë në ecurinë sa më të mbarë dhe efikas të Asamblesë, secili nga anëtarët apo përfaqësuesit e anëtarëve të Asamblesë së KOKSH është i/e mirëpritur për sqarime në lidhje me ndryshimet e propozuara të Statutit. Komiteti Teknik është i gatshëm të organizojë takime online me këdo nga anëtarët që ka pyetje apo dëshiron sqarime. Mundësisht na dërgoni paraprakisht me email pyetjet që keni duke nga kontaktuar në emailin e Komitetit Teknik [komiteti.teknik@gmail.com](mailto:komiteti.teknik@gmail.com).

Duke ju falenderuar për bashkepunimin, mirepresim kontributin tuaj.

Komiteti Teknik

Arjan Konomi  
Domenico DeMarinis  
Jerome Poivez  
Rezart Spahia  
Vojo Malo

Tiranë, me datë 20 Tetor 2020